



**William R. Hite, Jr., Ed.D.**  
Superintendent

Nëntor 2018

I dashur nxënës i klasës së 7-ë:

A e dini pse ky vit është shumë i rëndësishëm pér ju? Është pér shkak se notat, rezultatet e PSSA, dhe sjellja që keni këtë vit do të luajnë një rol vendimtar se në cilën shkollë tē mesme do të shkonit vitin e ardhshëm. Ne e dimë që ju dëshironi tē jeni sa më tē mirë dhe tē keni tē gjitha A-të dhe B-në, tē keni më pak se pesë (5) mungesa tē paarsyeshme, tē keni një sjellje shëmbullore dhe tē arrini rezultate sa më tē larta në teste - ju do të keni mundësinë tē zgjidhni midis 100 shkollave tē mesme gjatë Procesit tē Zgjedhjes së Shkollës.

Nuk mund tē theksojmë që kjo është e mjafreshme: ky është viti që ju tē shkëlqeni si nxënës. Punoni shumë, dëgjoni në klasë, bëni detyrat e shtëpisë dhe i ktheni në kohë, shkonit në shkollë në kohë dhe përdorni mënyra tē phekura pér zgjidhjen e konflikteve me bashkëmoshatarët tuaj. Kështu ju do të arrini suksese këtë vit dhe në tē ardhmen.

Drejtoria Arsimore ka shumë zgjedhje interesante pér shkollën e mesme. Tani është koha e përkryer pér ju që tē filloni tē studioni mundësitë tuaja dhe tē mendoni pér qëllimet tuaja tē ardhshme. Ju mund tē aplikoni në më shumë se pesë (5) shkolla tē mesme vitin e ardhshëm, kështu që bisedoni me këshilltarin tuaj, me prindërit ose me tē rritur që kujdesen pér jetën tuaj, rreth llojit tē shkollave tē mesme që dëshironi tē merrni pjesë. Udhëzuesi pér Shkollat e Mesme do t'ju ndihmojë tē mësoni rreth mundësive pér shkollat e mesme. Ju mund tē gjeni këtë udhëzues duke shkuar në [schoolselect.philasd.org](http://schoolselect.philasd.org) dhe duke klikuar në linkun e Udhëzues pér Shkollat e Mesme.

Unë dua që ju tē keni rezultate sa më tē mira këtë vit dhe tē bëni zgjedhje tē mira tē cilat do t'ju ndihmojnë ju tē arrini një niveli më tē lartë. Drejtori juaj, këshilltari, mësuesit, prindërit ose kujdestarët janë atje pér t'ju ndihmuar.

Ju uroj suksese tē vazhdueshme!

Sinqerisht,  


William R. Hite Jr., Ed.D.

WRH/dpw